



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA

www.komuna-kline.org



Kuvendi i Komunës Klinë

Komiteti për Politikë dhe Financa

01Nr 06-1216 /24

Klinë, dt: 08.03.24 /24

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e tretë e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur, më 08.03.2024, me fillim nga ora 09:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi, z. Fadil Gashi, i cili përshëndeti të gjithë anëtarët e Komitetit, drejtorin e Financave, z. Enver Berisha, OSBE-në, Policinë e Kosovës, zyrtarin e DKA-së, z. Astrit Muhamxheri dhe gjithë të pranishmit.

Gjithashtu, theksoi se përveç pikave të cilat janë për shqyrtim në rend të ditës, të futen si pika edhe dy kërkesa:

1. Propozim-vendimi i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, për ndarje të mjeteve financiare për organizimin dhe mbajtjen e festivalit folklorik "I Këndojmë Lirisë",
2. Propozim-vendimi i Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, për vënie në diskutim publik draft-rregulloren për taksa, tarifa dhe ngarkesa të tjera komunale.

Kryesuesi, prezantoi rendin e ditës:

1. Arsyetimi i mungesave;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Shqyrtimi i planit të punës për ekipin komunal për të drejtat e fëmijës 2024-2026;
4. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajin shkurt-mars 2024;
5. Të ndryshme.

Fadil Gashi, kryesues: Po besoj se rendin e ditës e keni marr bashkë me materialin. Për rend të ditës, për fillim e kam një kërkesë nga DFEZH që të futet në rend të ditës: draft-ndryshimi dhe plotësimi i draft-rregullores për taksa, tarifa dhe ngarkesa komunale. Kjo është veç përlëshuarje në shqyrtim, me marr vendimin në seancën e radhës, veç me lëshuar në diskutim publik. Drafti është i gatshëm, nëse doni me marr e marrim, po ashtu, kjo veç ka me u lëshuar në shqyrtim publik, pastaj ka me u analizuar, debatuar, plotësuar dhe ndryshuar. E rëndësishme është veç hapi iniciues me u iniciuar ndryshimet. Kjo është kërkesë e re, ne e kemi ndryshuar, nëse e keni parë ne e kemi ndryshuar. A ka dikush për rend të ditës? Atëherë kush është me këtë kërkesë të re për rend të ditës?

Pasi nuk kishte ndonjë vërejtje apo sugjerim, me 6 vota PËR u miratua rendi i ditës.

Pika 1. Arsyetimi i mungesave.

Fadil Gashi, kryesues: Ne po mundohemi të komunikojmë edhe me Tunë Dedën, po ende s'po kemi qasje të konfirmimit, përndryshe të tjerët jemi prezent.

Pika 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Fadil Gashi, kryesues: A ka dikush për proces?

Pasi nuk kishte ndonjë vërejtje apo sugjerim, kryesuesi hodhi në votim dhe me 6 vota PËR, u miratua procesverbalii nga mbledhja e kaluar.

Pika 3. Shqyrtimi i planit të punës për ekipin komunal për të drejtat e fëmijës 2024-2026.

Fadil Gashi, kryesues: Ne e kemi z. Astrit Muhaxheri këtu, e kisha lutur që të na bëjë një prezantim pasi e ka udhëhequr këtë grup për ta ndërtuar këtë draft të këtij plani.

Astrit Muhaxheri, zyrtar i DKA-së: Faleminderit, kryesues, mirëdita gjithëve! Shfrytëzoj rastin të ju falënderoj edhe të ju përshtëndes! Po besoj që Planin e Punës për të Drejtat e Fëmijëve

si dokument keni pasur mundësinë ta shihni, është një dokument ligjor që parashohin udhëzimet administrative që komuna duhet ta ketë. Normalisht, kryetari në bazë të kompetencave të tij ligjore e ka hartuar ekipin ashtu siç e parasheh Udhëzimi Administrativ 06-2022, kur thotë për themelimin dhe funksionimin e tij për të drejtat e fëmijëve do të thotë fillimi që veprimi i parë institucional duhet me u themeluar. Ajo është themeluar me vendim të kryetarit dhe pastaj ky ekip duhet të ketë edhe normalisht në plan se si me vepruar për një afat kohor të një mandat tre vjeçar. Ne si pjesë e ekipit, konkretisht edhe si koordinator i ekipit, kemi punuar në disa punëtori që me ofruar si draft, i kemi pasur edhe bashkëpunëtorët tjerë që na kanë ndihmuar, "Syri i Vizionit" nga Peja si organizatë bashkëpunuese dhe Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal dhe MAPL-në, që na kanë asistuar në hartimin e këtij plani. Ky plan, siç keni mundur ta shihni është për periudhën tre vjeçare, ku pjesën e parë të planit e ka pjesën e përshkrimit ku parashihen konventa ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve dhe veprimet se si duhet një plan të funksionojë, mandej ka shtuese ku parashihen aktivitetet brenda periudhës tre vjeçare dhe po ashtu në kuadër të këtyre aktiviteteve është edhe inkjadrimi i pjesës financiare që bashkërisht me akterë kompetentë, në këtë rast drejtoritë përkatëse që janë të inkjadruara në pjesën e atij plani, duke filluar nga Drejtoria për Financa, mandej Drejtoria e Arsimit, Drejtoria e Kulturës, dhe Drejtoria e Shëndetësisë. Do të thotë këto drejtori e kanë pjesën më të madhe që përfshihen aktivitetet për shkak që fëmijët janë pjesë e këtyre që gravitojnë në kuadër të atyre drejtorive e të aspektit finanziar. Ndoshta diskutime kemi pasur me drejtorin e Financave, ku i kemi dhënë disa shuma që ndoshta kemi shkuar në ato minimale sa i përket zbatimit të aktiviteteve dhe po besoj që ka gjithë zbatueshmëri në të ardhmen edhe fillimi që ka me u miratuar nga kuvendi komunal në seancën e radhës e pastaj si dokument me qenë publik edhe me u zbatuar në periudha kohore që parashihen. Po besoj që Udhëzimin Administrativ do të keni mundësi ta shihni sepse ky udhëzim e qartëson çartë se si me vepruar ky ekip komunal. Ky ekip kryesohet nga kryetari i komunës, mandej përbëhet nga akte tjera, po besoj anëtarët e ekipit veç keni pasur mundësinë të shihni cilët janë ata, disa prej tyre i kemi këtu, drejtorin, Enver Berisha dhe asamblisten, Mendehie Duraku. Kështu që, sa i përket planit, nëse ka dikush diçka mund të japid ndonjë sqarim më tepër, por sa i përket implikimit finanziar sepse këtu kemi pasur diskutime të shumta i kemi harmonizuar edhe dokumente tjera që vijnë nga komunat përreth, nga komuna e Istogut do të thotë pak a shumë e kemi adaptuar si plan të njëjtë, mirëpo sa i përket shumave ne kemi shkuar edhe për dallim prej komunave tjera që ndoshta për aktivitete të tillë kanë paraparë shuma më të mëdha. Ne do të mundohemi t'i minimizojmë ato dhe po besoj që një shumë që mund të zbatohet dhe aktivitetet që mund të realizohen, faleminderit!

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit, unë po hap debat, a ka dikush?

Enver Berisha, drejtor i FEZH: Faleminderit, kryesues, përhëndetje për të gjithë! Desha vetëm dy çështje me u lidh me z. Astrit, e para; kemi qenë të detyruar në njëfarë forme me shkuar në shuma minimale, për shkak se komuna nuk ka planifikuar buxhet për këtë kategori edhe këtë vit dmth s'kemi pasur hapësirë më shumë me paraparë mjete, ndërsa në vitet vijuese

do të shtojmë më shumë mjete sepse do ta shtrijmë edhe në projektbuxhet, edhe e dyta; ka qenë një debat bukur i madh rreth hartimit të këtij dokumenti me organizata të ndryshme, me ministri, me zyrtarë komunalë edhe ajo po ashtu është organizuar edhe një tryezë rreth hartimit të këtij drafti. Kështu që, besoj duke e përfshirë edhe përshtatjen si e tha Astriti me komunën e Istogut po kanë dhënë jashtëzakonisht kontribut të madh anëtarët e komisionit, OJQ-të, njerëzit që kanë ardhur nga institucione të caktuara edhe po besoj që është një dokument i pranueshëm dhe i nevojshëm faktikisht për të drejtat e fëmijëve. Kështu që, unë veç kisha me ju thënë që është mirë me rekomanduar për asamble dhe nëse ka nevojë për sqarime shtesë, ne jemi aty.

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit, drejtor, a ka dikush? Po, Tunë Deda?

Tunë Deda: Përvendetje për të gjithë! Kjo shumë mirë që është bërë, po edhe unë pajtohem me ju, drejtor, që thatë që vitet e ardhshme me rritë buxhetin. Kështu që, ta keni parasysh që përvitin e ardhshëm për këta fëmijë që janë shumë me nevojë, që kanë nevojë për përkujdesje të veçantë, me rrit buxhetin sa më shumë që është e mundur, mos me kursyer për ta.

Fadil Gashi, kryesues: Po, Asdren?

Asdren Ramadani: Faleminderit, kryesues! Unë e përgëzoj Drejtorinë e Arsimit për angazhimin që kanë përgatitur këtë plan për të drejtat e fëmijëve, po kisha dashur të shtoj edhe një pikë përend të ditës nëse më lejohet, atëherë po e lë tek të ndryshmet.

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit, dikush tjetër? Tash ndoshta edhe një dilemë timen që e kam pasur ndoshta me arsy, tash edhe drejtori e konfirmoi sepse kostoja financiare e këtij plani nuk është bash e vogël, janë 429,000.00 euro, po për tri vite, po tash e kemi edhe vitin e parë, veç le ta sqarojë mirë drejtori se tani kur e marrim vendimin më në kuwend e kemi problem, ne po e kemi problem, s'po ja vëni numrin e faqeve, e keni 310,000.00 euro që sigurohen prej komunës, po 310,000.00 thotë merren edhe kur ta marrim vendimin ne në kuwend duhet me ditë se veç n'këtë plan shkojnë ato edhe menjëherë më poshtë i ka edhe 150,000.00 tjera, për këtë vit që jemi. Për këtë unë i kam thënë edhe Ahmetit ka komunikuar me këta, këtë draft që e kam unë përpara, nevojat buxhetore rifillojnë me këto, po si shumë e përgjithshme tash këtu po del 429,000.00 euro, si shumë e përgjithshme është, për 3 vite tani, po është mirë me parë këtë draft se kur të marrim vendimin në kuwend më pardon nuk ka. Veç te kostoja financiare është mirë edhe njëherë ju me Drejtorinë e Financave më së miri e ke ti me sqaruar deri të shkojmë në seancë, shikoni edhe nuk ka këtu dilema a është i mirë a s'është, do të thotë ne gjithë po pajtohami me këtë, edhe si plan i punës edhe për kënd i dedikohet veç te shumat rehatohuni. Shikoni se tani jeni pa mjete, se kur të nxjerren vendime ato bllokohen këto kategori edhe ju merren këtyre drejtorive këto mjete, e ju keni planifikuar sipas buxhetit komunal diçka tjetër se ne e morëm edhe buxhetin këtu, këtu planifikohen diçka tjetër, ne me vendim të kuvendit ne tani duhet me marr m'i orientuar këto. Ndoshta është mirë deri në seancë, ne se kemi për ngut me i

parë edhe njëherë çka mundet edhe mos me pasur dilema financiare se kur merren vendimet 100 telashe po na dalin duke i sanuar, ndryshuar. Urdhëro, Tunë?

Tunë Deda: Kryesues, se nuk e pata materialin edhe desha me sqaruar mirë këtë se disi po i bie shumë, 300,000.00 veç për këtë vit nuk është në rregull.

Astrit Muhaxheri: Realisht koston e përgjithshme financiare e kanë rritur investimet kapitale, sepse plani për të drejtat e fëmijëve flet edhe për mjediset ku fëmijët mund të kenë rekreacione, p.sh., te parqet, ndërtimi i parqeve dhe në konsultim me Drejtorinë e Financave, përkatesisht me Melihaten. Na i ka dhënë shënimet që brenda një viti sa bëhet investimi nga komuna për ndërtimin e parqeve që janë duke bërë nëpër zona rurale dhe kjo e ka rritur atë koston e përgjithshme. Mirépo, sido që të jetë, ne prapëserapë kemi komunikuar edhe me Ahmetin edhe na ka dhënë edhe si propozim që ta shkojmë në detaje. Ne do të ndalemi edhe njëherë me Drejtorinë e Financave, m'i analizuar këto shuma sa i përket investimeve kapitale, mandej me konkretizuar tamam si plan të realizueshëm.

Fadil Gashi, kryesues: Pikërisht këtë edhe unë po e them, se ne e kemi planifikuar aty për parqe, i kemi planifikuar me kode të veçanta janë ato, nëse ne nxjerrim një vendim të ri me këto shuma, pavarësisht që i thuhen të njëjtat projekte, kodi është i veçantë i vendimit për buxhet. Është mirë me i harmonizuar sepse dalin dualizma në vendime.

Enver Berisha, drejtor i FEZH: Ne mund ta përmendim si projekte në kuadër të planit, po mjetet financiare janë prej kodeve të parapara.

Astrit Muhaxheri: Do të thotë, këtu flitet vetëm për projektet që kontribuojnë në zhvillimin e fëmijëve.

Fadil Gashi, kryesues: Po, bisedoni ju me ata edhe nëse ju hyn në shërbim mirë, edhe me dëgjuar edhe m'i sanuar këto, se drejtori e di sa herë po na i kthejnë prej ministrisë, e ne tani po duhet me i kthyer vendimet tona, tani pa fajin tonë po na ligështohet edhe performanca. Sa herë të ndryshojnë vendimet ne çdo herë shkojmë duke marr nga një vazhdë...

Astrit Muhaxheri: Më poshtë nëse është 150,000.00 këtu është gabim teknik, se këtu është 15,000.00, kjo po ndërlidhet me DKRS-në sepse ne si draft jua kemi dërguar në exel gjitha drejtorive, kanë pasur m'i përmirësuar dmth në aspektin financier, po këtu është shuma 15,000.00, jo, 150,000.00, po e përmirësojmë këtë sido që të jetë, gabim teknik është.

Fadil Gashi, kryesues: Ani a po pajtohem i kështu; le të sanohen këto defekte çka ka deri në seancë edhe në seancë ne prapë e kemi shqyrtau pak, prapë jemi këtu. Atëherë, kush është për ta rekomanduar për kuvend?

Komiteti për Politikë dhe Financa, me 7 vota PËR, pas shqyrtimit të draft-planit të punës për ekipin komunal për të drejtat e fëmijës 2024-2026, rekomandoi që deri në mbajtjen e seancës të verifikohen dhe të analizohet plani i veprimit për zbatimin e këtij plani, pasi që ka kosto financiare. Po ashtu, u rekomandua që i njëjti të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Pika 4. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajin shkurt-mars 2024.

Fadil Gashi, kryesues: Kërkesa nuk kemi kësaj radhe.

Pika 5. Kërkesë nga DFEZH për vënienë në diskutim publik draft-rregulloren për taksa, tarifa, gjoba dhe ngarkesa komunale.

Fadil Gashi, kryesues: Drafti është i gatshëm, rregulloren e kemi. Është fjala me u iniciuar ndryshimi i kësaj rregullore dhe propozimet që na vijnë, qoftë prej drejtorisë, qoftë prej subjekteve tjera ose biznesore ose çfarëdo t ‘jetë, ne bëjmë shqyrtim publik, bëjmë debat, në fund mundemi për miratim, a ka dikush për këto? Kush është për rekomandim?

Sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, Komiteti për Politikë dhe Financa, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, me 7 vota PËR, rekomandoi që draft-rregullorja për taksa, tarifa dhe ngarkesa të tjera komunale, të kalojë për shqyrtim në Kuvend dhe të merret vendim për ta vënë në diskutim publik.

Pika 6. Kërkesë nga DKRS për ndarje të mjeteve në shumën prej 25.000,00 për mbajtjen e festivalit folklorik “I këndojmë lirisë.”

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, për ndarje të mjeteve financiare në shumë prej 25 mijë euro për mbajtjen e festivalit folklorik “I Këndojmë Lirisë”, me 7 vota PËR, rekomandoi që kërkesa të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Pika 7. Të ndryshme.

Fadil Gashi, kryesues: Po, Asdren?

Asdren Ramadani: Faleminderit, kryesues! Pasi ishte tema për të drejtat e fëmijëve, ne si komitet, nëse pajtoheni të gjithë kolegët me një vendim për seancë, për të gjitha shkollat siç kanë filluar edhe disa shkolla në Kosovë, duke i ndaluar telefonat nëpër shkollë nxënësve, sepse rritet interesimi i mësimit edhe gjatë orëve edhe parandalohen edhe problemet, ngacmimet, bullizmi grupacionet e nxënësve e shumë tjera, edhe të gjithë arsimtarëve apo profesorëve të ju ndalojen telefonat në orën e mësimit, se kemi disa ankesa nga prindërit. Disa arsimtarë jua shkruajnë nga një detyrë në tabelë edhe tërë orën e kalojnë dmth në rrjete sociale. Të merret një vendim për ata arsimtarë që përdorin telefonin gjatë orëve në mësim dhe të dëshmohet në heqjen e mëditjes të mësimdhënësve, pse edhe kjo komuna jonë mos ta merr një vendim ashtu nga kuvendi. Faleminderit, kryesues!

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit, ne mundemi në seancën e radhës me pyet drejtorin ose m'i thënë drejtorit të angazhohen më shumë, qofshin ata edhe radikal në kuptimin e masave ligjore, jo jashtë tyre.

Astrit Muhaxheri: Në fakt, sa i përket përdorimit të telefonave nëpër shkolla, ekziston rregullorja e kuvendit komunal e aprovuar në vitin 2016, ku flet për masat e ndaluara edhe përmësimdhënësit edhe për nxënësit edhe si pikë e veprimeve të ndaluara është edhe përdorimi i telefonave me institucionet shkollore. Se sa po punohet në këtë drejtim dhe sa është e zbatueshme kjo rregullore, ndoshta është temë që duhet me u diskutuar, mirëpo si legjislacion, si vendim komunal, ekziston. Është edhe në fuqi, mirëpo ndoshta me u diskutuar në kuptimin e saj se sa po zbatohet kjo rregullore, ndoshta kjo ka nevojë të diskutohet. Mirëpo, si dokument ligjor që mund të zbatohet e kanë gjitha institucionet shkollore edhe është dokument që është aprovuar në kuvend komunal në vitin 2016.

Fadil Gashi, kryesues: A bën kështu, a mundemi ne me bërë si kërkesë zyrtare që në seancën e radhës drejtori i drejtorisë le të raportojë, a mundemi ne me bërë si kërkesë zyrtare si KPF edhe drejtori i drejtorisë seancën e radhës me na dhënë një sqarim rrëth implementimit të rregullores? Atëherë, a ka edhe dikush për të ndryshmet?

Tunë Deda: Tek të ndryshmet, po më bie shpesh me përmend për këto raste, tash kam dëgjuar se e kanë ngrënë një person qentë! Duhet me bërë një zgjidhje, m'i bërë shkresë komuna qeverisë, që le ta bëjë një zgjidhje.

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas kërkesave të anëtarëve të këtij komiteti, me 7 vota PËR, rekomandoi që Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente në seancën e cila do të mbahet në muajin mars të informojë kuvendin në lidhje me trajtimin e qenëve endacakë.

**Procesmbajtësja,
Monika Palushi**



**Kryesuesi,
Fadil Gashi**

